



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA TIRANË

AGJENCIA E PARQEVE DHE REKREACIONIT

Nr. 83 prot.Tiranë më 13.01.2025

Lënda: Kthim përgjigje

ZONJËS ILDA KOÇI

Adresa: Rruga "Nasi Pavlla" Pallati Edil-Al, Shkalla 1, Ap. 8

Cel: 069 44 60 839

TIRANË

Për dijeni:

**KOMISIONIERIT PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E TË
DHËNAVE PERSONALE**

Adresa: Rruga "Abdi Toptani", Ndërtesa nr. 5

TIRANË

E nderuar znj. Koçi,

Pranë Agjencisë së Parqeve dhe Rekreacionit është përcjellë shkresa me nr. I-19024 prot. datë 20.11.2024, në të cilën është kërkuar informacion mbi zbatimin e projektit për ndërtimin e një shenjtore në ndër të Shenjtës Nënë Tereza.

Në përgjigje të shkresës tuaj ju bëjmë me dije si më poshtë vijon:

Bashkia Tiranë ka nënshkruar me Arqipeshkëvinë Metroplitanë të Kishës Katolike Tiranë-Durrës, Memorandumin e Mirëkuptimit me nr. 24545/2 prot., datë 31.08.2022, i cili është miratuar nga Këshilli Bashkiak me vendimin nr. 106, datë 15.11.2022 "Për miratimin e Memorandumit të Mirëkuptimit midis Bashkisë Tiranë dhe Arqipeshkëvisë Metroplitanë të Kishës Katolike në Tiranë-Durrës si dhe kalimin e së drejtës së përdorimit të pronës me nr. 359/1, ZK.2954" ku është dhënë e drejta e kalimit e së drejtës së përdorimit të pronës me nr. 359/1, zk. 2954 Kodi Unik 2954005205, e llojit "Pyll" dhe sipërfaqe 17.592 m².

Mbështetur në të dhënat e regjistrit kadastral pyjor e kullosor, sipërfaqja 1,7592 ha, është pjesë e ngastës pyjore 15a, të ekonomisë pyjore e kullosore Krrabë – Gurrë 2, ID Pronës

1238, Kodi TR 2400015A, e cila ka kaluar në pronësi të Bashkisë Tiranë me VKM-në 134 datë 03.03.2021, "Për disa shtesa e ndryshime të vendimit nr. 433, datë 08.06.2016 të Këshillit të Ministrave "Për transferimin në pronësi të Bashkive të pyjeve dhe kullotave publike, dhe aktualisht në administrim të Ministrisë së Mjedisit e të ish Komunave/Bashkive", të ndryshuar, administrimi i të cilave i është kaluar Agjencisë së Parqeve dhe Rekreacionit me anë të Vendimit të Këshillit Bashkiak nr. 28, datë. 23.05.2016 "Për kalimin e funksioneve të mirëmbajtjes së rrugëve rurale, ujitjes dhe kullimit pranë D.P.N.2, si dhe Administrimin e Pyjeve dhe Kullotave, pranë Agjencisë së Parqeve dhe Rekreacionit".

Agjencia e Parqeve dhe Rekreacionit, me urdhrin nr. 142, datë 20.04.2023, nr. 694 prot., datë 20.04.2023, ka ngritur grupin e punës, për hartimin e raportit tekniko – ekonomik, i cili ka hartuar raportin mbi studimin tekniko ekonomik për heqjen e sipërfaqes prej 1.7592 ha, pasuria me nr. 359/1, zk.2954, fshati Picall, Kod Unik 2954005205 të fondit pyjor dhe kullor nga fondi pyjor dhe kullor në pronësi të Bashkisë Tiranë.

Në vijim, Agjencia e Parqeve dhe Rekreacionit me shkresën nr. 694/2 prot., datë 05.05.2023, ka dërguar në Bashkinë Tiranë, informacion mbi procedurën e ndjekur në përmbushje të Vendimit të Këshillit Bashkiak nr. 106, datë 15.11.2022, për heqjen e sipërfaqes pyjore nga fondi pyjor publik në pronësi të Bashkisë Tiranë dhe raportin mbi studimin tekniko – ekonomik.

Me qëllim ndërtimin e shenjtore Këshilli Bashkiak i Tiranës ka dalë me vendimin nr. 60, datë 09.05.2023 "Për dhënien e miratimit për vazhdimin e procedurave të heqjes së sipërfaqes prej 1.7592 Ha nga fondi pyjor pyblik, e shtrirë në ngastrën pyjore 15a të ekonomisë pyjore Krrabë-Gurrë 2, me nr. pasurie 359/1, ZK 2954, në pronësi të Bashkisë Tiranë, me qëllim ndërtimin e shenjtore në ndër të të Shenjtës Nënë Tereza", ku është dhënë miratimi për vijimin e procedurave për heqjen nga fondi pyjor të sipërfaqes prej 1.7592 Ha si dhe është ngarkuar Agjencia e Parqeve dhe Rekreacionit për përditësimin e kadastrës pyjore e ndjekjen e procedurave për heqjen nga fondi pyjor pranë Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit.

Me qëllim zbatimin e Vendimit të Këshillit Bashkiak nr. 60, datë 09.05.2023, Agjencia e Parqeve dhe Rekreacionit, me shkresën nr. 836/1, datë 07.06.2023, i është drejtuar Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit me kërkesë për nisjen e procedurës për heqjen e sipërfaqes nga fondi pyjor.

Ministria e Turizmit dhe Mjedisit me shkresën nr. 3718/1 datë 19.06.2023 ka bërë me dije se kërkesa për heqje nga fondi pyjor kryhet sipas përcaktimeve të pikës 1, Kapitullin II, të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 888, datë 27.12.2022, vendim i cili ka shfuqizuar Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 1353, datë 10.10.2008 "Për përcaktimin e rregullave

për paraqitjen e kërkesës, mbajtjen dhe plotësimin e dokumentacionit teknik, si dhe të kritereve e të procedurave të zvogëlimit të sipërfaqes e të vëllimit të fondit pyjor”, e ndryshuar (në fuqi në momentin e lidhjes së Memorandumit të Mirëkuptimit me nr. 24545/2 prot., datë 31.08.2022), si dhe plotësimi i dokumentacionit kryhet në përputhje me pikën 2, Kapitullit III, të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 888, datë 27.12.2022.

Duke ju falenderuar,

DREJTOR I PËRGJITHSHËM

